

V E N D I M
Nr.579, datë 8.12.1999

**PER KUSHTET DHE MASËN E PËRFITIMEVE NGA SIGURIMI SHOQËROR
SUPLEMENTAR I USHTARAKËVE DHE ANËTARËVE TË FAMILJEVE TË TYRE NË
RASTET E NXJERRJES SË TYRE NË REZERVË, LIRIM APO PENSION**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21, të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Kombëtar", me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

I. PERSONAT PËRFITUES

1. Në rastet e nxjerrjes në rezervë, lirim a pension, përfitojnë nga sigurimet shoqërore suplementare për ushtarakët, personat si vijon :

- a) Oficerët dhe nënoficerët e Forcave të Armatosura, të Ministrisë së Rendit Publik, të Shërbimit Informativ Kombëtar dhe të strukturave të ish-Ministrisë së Brendshme;
- b) policët;
- c) ushtarët rrogatë;
- d) familjarët në ngarkim të personave të treguar në shkronjat "a", "b" dhe "c" të kësaj pike, të cilët kanë humbur jetën.

2. Personat e përmendur në pikën 1 më sipër, përjashtohen nga përfitimi i sigurimeve shoqërore suplementare në rastet si vijon :

- a) kur nxirren në lirim për shkak se kanë braktisur detyrën;
- b) kur janë dënuar me burgim për kryerje të krimeve dhe kundërvajtjeve penale ushtarake me një vendim të formës së prerë të gjykatës.

II. KUSHTET PER PERFITIM

A. Periudhat e vlefshme për përfitim

Në mbështetje të nenit 7 të ligjit, njihen dhe llogariten në kohën e shërbimit aktiv sa vijon:

- 1. Koha e shërbimit të përhershëm të ushtarakut (oficer, nënoficer, polic, ushtar rrogëtar).
- 2. Koha e shërbimit në të cilën ushtarakët aktivë kanë marrë pjesë apo kanë ushtruar detyrat, funksionet a profesionet e treguara në listën bashkëlidhur këtij vendimi. Kjo kohë shërbimi, për efekt të llogaritjes së pensionit suplementar të pleqërisë, invaliditetit dhe atij familjar, njihet dhe llogaritet në masën 1.5 fish.

3. Koha e plotë e vuajtjes së dënimit a internimit për motive politike, nëse përmbushen njëkohësisht këto kushte :

- a) kanë qenë të dënuar ose të internuar për motive politike, pavarësisht nëse kjo periudhë është në vazhdim ose jo të një periudhe të shërbimit ushtarak aktiv;
- b) kanë përfituar nga ligji nr.7514, datë 30.9.1991, "Për pafajsinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të të përndjekurve politikë";
- c) pas periudhës së dënimit ose të internimit për motive politike, në vazhdim ose jo, kanë jo më pak se 5 vjet shërbim ushtarak aktiv në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në strukturat e Ministrisë së Rendit Publik dhe në Shërbimin Informativ Kombëtar.

B. Të ardhurat në bazë të të cilave llogariten përfitimet

1. Në pagën referuese do të përfshihen: paga bazë për funksion dhe shpërblimi për gradën ushtarake.

Në pagën bazë për funksionin përfshihen :

- a) paga bazë për klasën e funksionit organik;
- b) shtesa për vjetërsi;
- c) shtesa për vështirësi vendi e shërbimi;
- d) shtesa për natyrë të veçantë pune.

2. Paga bazë për funksionin, për efekt të llogaritjes së përfitimeve nga ky ligj :

a) për ushtarakët e shërbimit aktiv, që kanë dalë në rezervë ose në lirim para datës së shtrirjes së efekteve financiare të ligjit nr.8521, datë 30.7.1999, është paga që ka ushtaraku i shërbimit aktiv me po atë funksion apo detyrë, në 1 janar 1999;

b) për ushtarakun e shërbimit aktiv, që ka dalë në rezervë ose në lirim gjatë periudhës 1 janar 1999 dhe datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr.8521, datë 30.7.1999 dhe e drejta për të përfituar sipas ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 i ka lindur në çastin e daljes në rezervë ose në lirim, është paga që ka pasur vetë ushtaraku në këtë çast;

c) për ushtarakun e shërbimit aktiv, që ka dalë në rezervë ose në lirim pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.8521, datë 30.7.1999, dhe e drejta për të përfituar sipas ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 i ka lindur në të njëjtin çast me daljen në rezervë ose në lirim, është paga që ka patur ushtaraku aktiv në këtë çast;

ç) për ushtarakun e shërbimit aktiv, që ka dalë në rezervë ose në lirim pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.8521, datë 30.7.1999, dhe e drejta për të përfituar i ka lindur në një periudhë të mëvonshme, është paga që ka ushtaraku aktiv në po atë funksion apo detyrë në çastin që i lind e drejta për përfitim.

III. MASA E PËRFITIMIT

1. Ushtaraku i shërbimit aktiv për kohën që ndryshon vendin e punës, për efekt rehabilitimi ose parandalimi për sëmundje, merr përfitim suplementar në kompensim të pagës referuese, me kusht që shuma e përfitimeve nga paga, sigurimi i detyrueshëm shoqëror dhe sigurimi suplementar të mos kalojë 100 për qind të pagës referuese.

2. Ushtarakut të shërbimit aktiv, që del në rezervë ose në lirim dhe nuk plotëson kushtet për pagë kalimtare, i jepet pension i parakohshëm për vjetërsi shërbimi në këtë çast, në rast se ai plotëson kushtet e parashikuara në ligj për këtë lloj pensioni.

3. Masa e pensionit suplementar të pleqërisë për ushtarakët e shërbimit aktiv nuk mund të jetë më e lartë se 50 për qind e pensionit të pleqërisë, që përfiton vetë ushtaraku nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror.

4. Masa e pensionit suplementar të invaliditetit për ushtarakët e shërbimit aktiv, nuk mund të jetë më e lartë se 50 për qind e pensionit të invaliditetit që përfiton vetë ushtaraku, nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror.

IV. DOKUMENTACIONI PËR PËRFITIM DHE ADMINISTRIM

1. Për efekt të llogaritjes së përfitimeve nga ky ligj, institucionet përkatëse dërgojnë për personat e interesuar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore këto dokumente :

a) Vërtetimin për periudhën e shërbimit aktiv, sipas formatit-tip, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Vërtetimin për pagën referuese, sipas formatit-tip, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

Vërtetimet e mësipërme, në bazë të kërkesës së personave të interesuar do të plotësohen nga drejtoritë e personelit dhe të financës të ministrisë së mbrojtjes, të ministrisë së rendit publik dhe të shërbimit informativ kombëtar, pasi ato të kenë shqyrtuar dokumentacionin përkatës.

2. Personat e interesuar paraqesin pranë organeve të sigurimeve shoqërore kërkesën dhe dokumentacionin e nevojshëm për caktimin e përfitimit suplementar ushtarak.

V. FONDI I SIGURIMIT SUPLEMENTAR PËR USHTARAKET

1. Krijohet fondi i sigurimit suplementar të ushtarakut, i cili financohet dhe garantohej nga buxheti i shtetit.

a) të ardhurat në fondin e sigurimit suplementar për ushtarakët përbëhen nga financimet, me destinacion të buxhetit të shtetit, të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

b) shpenzimet e fondit të sigurimit suplementar për ushtarakët përfshijnë ::

e) përfitimet suplementare për rehabilitim dhe parandalim për sëmundje;

f) pensione të parakohshme për vjetërsi shërbimi;

g) pensione suplementare;

h) shpenzime administrative.

2. Fondi i sigurimit suplementar për ushtarakët programohet në të njëjtat afate, si dhe fondi i sigurimit të detyrueshëm shoqëror dhe miratohet çdo vit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si zë i veçantë në buxhetin e shtetit.

3. Financimet buxhetore, me destinacion për fondin e sigurimit suplementar për ushtarakët, tërhiqen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, sipas kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Buxhetit

dhe Drejtoria e Thesarit, në Ministrinë e Financave, dhe depozitohen në Bankën e Kursimeve.

4. Dokumentacioni, që autorizon dhe vërteton pagesën e përfitimeve që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji, përcaktohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

VI. EFEKTET FINANCIARE

1. Efektet financiare të përballohen për shumën 250 milionë lekë nga fondi i kontingjencës dhe 150 milionë lekë nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave. Shërbimet administrative të përballohen nga fondet e sigurimeve shoqërore.

2. Institucionet përkatëse, të krijojnë strukturat për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi. Efektet financiare përballohen nga buxheti i miratuar për ato institucione për vitin 1999.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Financave, Shërbimi Informativ Kombëtar dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore të nxjerrin një udhëzim të përbashkët, për mënyrën e lëvizjes së informacionit për ushtarakët.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për hartimin e udhëzimeve, të rregullores dhe të dokumentacionit për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta

STRUKTURAT DHE FUNKSIONET ORGANIKE PËR TË CILAT VJETËRSIA E SHËRBIMIT SI USHTARAK AKTIV, LLOGARITET 1.5 FISH, PËR EFEKT TË PËRFITIMIT TË PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË USHTARAKUT

I. Në Ministrinë e Mbrojtjes:

1. Ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm në operacionet luftarake brenda e jashtë vendit.

2. Ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm në funksionet organike të strukturës ushtarake "Batalion special i brigadave KOMANDO" si më poshtë:

a - Komandanti i batalionit;

b - shefi i shtabit;

c - shefi operativ;

d - shefi i zbulimit;

e - komandant grupi special;

f - specialist për përgatitjen xheniere;

g - specialist për përgatitjen fizike;

h - specialist për aparaturat e zbulimit;

i - specialist zbulimi në grupin special;

j - shoferi i autoveturës së komandantit të batalionit;

k - ushtarë rrogëtarë (profesionist).

3. Ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm në repartet e Aviacionit Ushtarak si më poshtë:

A. Në funksionet organike pilot:

a - Komandant, zëvendëskomandant i F. Ajrore (pilot);

b - shefi i analizës dhe vlerësimit të f. ajrore;

c - specialist për qitje taktike ajrore të f. ajrore;

d - specialist për navigacionin në f. ajrore;

e - komandant baze ajrore, regjimenti aviacioni;

f - shef shtabi bazë ajrore, regjimenti aviacioni;

g - shef i teknikës ajrore për bazë ajrore dhe regjiment aviacioni;

h - kryeaviodrejtues i planizimit të stërvitjes në bazë e regjiment aviacioni;

i - aviodrejtues, zëvendëskomandant skuadrilje, ai dhe për rrezikshmërinë e fluturimit;

j - zëvendëskomandant skuadrilje aviodrejtues;

k - komandant katërshe;

l - komandant çifti;

ll - komandant ekuipazhi.

B. Në funksionin organik bordteknik:

a - Teknik helikopteri (fluturues);

b - teknik avioni An-2 (fluturues).

C. Në funksionin organik aviodrejtues:

a - Aviodrejtues (fluturues në aeroplanin bombardues tip IL-28)

D. Në funksionin organik radist fluturues e shënjues:

a - Radist fluturues e shënjues (nënoficer aktiv fluturues në aeroplanin IL-28).

E. Në funksionin organik të shërbimit SAR:

a - Shef i degës së shërbimit SAR

4. Ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm në Forcat Detare si më poshtë:

A. Në funksionin organik të nëndetësve

a - Komandant nëndetëse;

b - zëvendëskomandant;

c - shef shtabi;

d - shef operativ;

e - shef i lundrimit;

f - shef i minë-silurës;

g - zëvendësshef i minë-silurës

h - shef i ndërlidhjes;

i - zëvendësshef i ndërlidhjes;

j - shef i shërbimit radioteknik;

k - shef i elektro-mekanik;

l - zëvendësshef i elektro-mekanik;

ll - shef i personelit;

m - shef i kimisë;

n - shef i zbulimit;

nj - shef i shëndetësisë;

o - zëvendësshef i shëndetësisë;

p - oficer nëndetëse;

q - nënoficer nëndetëse.

B. Në funksionin organik të strukturës së zhytjes:

a - Komandant i repartit special të zhytjes;

b - zëvendëskomandant i repartit special të zhytjes;

c - kryepolumbar në repartin special të zhytjes;

d - polumbar në repartin specil të zhytjes;

e -shef i shtabit dhe i përgatitjes polumbare në grupin e anijeve avari-shpëtuese;

f - mjek fiziolog në grupin e anijeve avari-shpëtuese;

g - komandant i anijeve polumbare;

h - ndihmës mjek në anijen polumbare;

i - kryepolumbarist;

j - polumbarist.

5. Ushtarakët e shërbimit aktiv të përhershëm që punojnë në laboratorët e kimisë së ushtrisë me lëndë helmuese luftarake dhe në vende pune me rrezatim radioaktiv.

II. Në Ministrinë e Rendit Publik:

1. Ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm në funksionet organike të strukturës së repartit "RENEA", si më poshtë:

a) - Komandant;

b) - zëvendëskomandant,

c) - shef shtabi

d) - shef operativ;

- e) - shef stërvitjeje;
- f) - instruktor i përgatitjes së trupës speciale;
- g) - Negociator;
- h) - Komandant grupi;
- i) - Trupa speciale
- j) - trupa speciale (me detyra të ndryshme).

2. Ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm në funksionet organike të strukturës së repartit special 77 dhe repartin e operacioneve speciale të policisë, si më poshtë:

- a) - Komandant;
- b) - Zëvendëskomandant.;
- c) - Komandant grupi;
- d) - Instruktor përgatitje;
- e) - Komandant nëngrupi;
- f) - Trupa speciale (me detyra të ndryshme).

3. Ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm në funksionet organike të grupit të helikopterëve dhe helikopterëve të personaliteteve të larta shtetërore, si më poshtë:

- a) - Komandant;
- b) - Zëvendëskomandant;
- c) - Pilot;
- d) - Teknik helikopteri (fluturues);

4. Ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm në funksionet organike të strukturës së repartit të policisë "BRISKU", si më poshtë:

- a) - Komandant;
- b) - Zëvendëskomandant;
- c) - Shef shtabi;
- d) - Shef stërvitjeje;
- e) - Instruktor përgatitjeje;
- f) - Komandant grupi;
- g) - Instruktor grupi.
- h) - Trupa speciale (me detyra të ndryshme).

5. Ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm në funksionet organike të strukturës së Degës së Personaliteteve të Larta Shtetërore, si më poshtë:

- a) - Kryetar dege;
- b) - Zëvendëskryetar dege;
- c) - Shofer.

6. Ushtaraku i shërbimit aktiv të përhershëm në funksionet organike të strukturës së ruajtjes e shoqërimit të: Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryetarit të Kuvendit, Zëvendëskryeministrit, Ministrit të Rendit Publik, të Mbrojtjes, të Punëve të Jashtme, të Financave, të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Kryetarit të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kryetarit të Shërbimit Informativ Kombëtar, ish - Presidentit të Republikës, ish-Kryetarit të Kuvendit, ish-Kryeministrit, ministrave të tjerë, Sekretarit të Shtetit, të ish- Zëvendëskryeministrit, të ish-Ministrit të Rendit Publik, ish-Ministrit të Mbrojtjes, ish- Ministrit të Financave, dhe për ruajtjen e shoqërimit e delegacioneve të huaja, si më poshtë:

- a) - Shef seksioni;
- b) - komandant grupi (përgjegjës);
- c) - zëvendëspërgjegjës grupi;
- d) - shoqërues (me detyra të ndryshme)
- e) - shoqërues (me detyra të ndryshme)
- f) - trupa shërbimi;
- g) - shofer.

III. Në Shërbimin Informativ Kombëtar:

1. Ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm në funksionet organike të Drejtorisë kundër krimit të organizuar dhe Drejtorisë së Antiterrorit:

- Drejtor;
- zëvendës drejtor;
- kryetar dege;
- kryeinspektor;
- inspektor;
- shef bazë;
- përgjegjës vëzhgimi
- vëzhgues.

2. Ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm në funksionet organike të Degëve dhe seksioneve në bazë të Krimit të Organizuar dhe Antiterrorit:

- Kryetar dege;
- Kryeinspektor;
- Inspektor;
- Vëzhgues.